



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
T I R A N Ë

---

Bulevardi "Gjergj Fishta" Tiranë, Tel: 042228909 (nr.brendshëm116), Fax: 042247168  
[www.gjykatatirana.gov.al](http://www.gjykatatirana.gov.al)

Tiranë më dt. 01/03/2023

**Njoftim për shtyp**

Nisur nga interesimi i medias dhe rëndësia e ngjarjes së djeshme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, jep këtë njoftim për shtyp për të sqaruar se: Në lidhje me shtetasin D.H. nga kjo Gjykatë është dhënë një vendim për veprën penale "Dhunë në familje" parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, pasi **në datën 16.06.2022**, rreth orës 12:00, është bërë kallëzim në shërbimet e policisë nga shtetasja E.H. Në lidhje me kete kallëzim është bërë arrestimi i shtetasit D.H. dhe është caktuar masa e sigurimit "Arrest në burg" **ne daten 19.06.2022**.

Pas përfundimit të hetimeve, **në datën 19.10.2022**, Prokuroria e Tiranës, ka sjellë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesën për "Dërgimin në gjyq" për veprën penale të "Dhunë në familje" parashikuar nga neni 130/a/1 te Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit D.H.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, të zhvilluar në prani të prokurorit, të të pandehurit dhe në mungesë të viktimës, edhe pse e njoftuar rregullisht, u kërkuar nga ana e të pandehurit dhe mbrojtëses së tij, zhvillimi i gjykimit me anë të gjykimit të shkruar bazuar në nenin 332/c dhe 403 te K.Pr.Penale, kërkesa të cilat nuk u kundërshtuan as nga organi i akuzes.

Gjykata, duke marrë në kosnideratë faktin se, nga palët nuk u paraqitën kërkesa për pavlefshmëri apo papërdorshmëri provash apo kërkesë për marrje provash të tjera; duke marrë në konsideratë se nuk u konstatua palvlefshmëri absolute apo papërdorshmeri të akteve si dhe duke konstatuar se, çështja zgjidhej në gjëndjen që janë aktet, detyrimisht vendosi pranimin e kërkesës së të pandehurit për gjykim të shkurtuar.

Gjatë gjykimit të çështjes në themel, nga ana e të pandehurit është bërë kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit nga "Arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, me atë të "Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, duke parashtruar si motiv gjëndjen shëndetsore dhe sëmundjen kronike. Pasi dëgjoi pretendimet e mbrojtëses dhe të pandehurit që kërkonin zëvendësimin e masës, pasi dëgjoi dhe prokurorin, i cili ishte dakort me zëvendësimin e masës, gjyqtari Gerd Hoxha vendosi me vendimin me nr.555/1

datë 09.01.2023, Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit D.H., vendim i cili është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në datën 14.02.2023.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes në themel, nga organi i prokurorisë u kërkuar dënimi i të pandehurit me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe më pas aplikimi i kërkesave të nenit 403 të K.Pr.Penale, dënimit e tij përfundimisht me 1 (një) vit burgim.

**Në datë 08.02.2023**, Gjykata pasi administroi edhe tre deklarata noteriale që theksonin normalizimin e marrëdhënieve mes palëve, si dhe akte të tjera që vërtetonin gjëndjen e rëndë shëndetësore të nënës së të pandehurit, e cila jetonte vetëm me këtë të fundit, deklaroi të pandehurin D.H. fajtor për kryerjen e veprës penale të “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal dhe dënimit e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 e K.Pr.Penale, e dënoi përfundimisht të pandehurin me 1 (një) vit burgim. Vuajtja e dënimit i fillon të pandehurit nga dita e arrestimit të tij në flagrancë në datën 16.06.2022.

Në datën 15.02.2023, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pandehuri D.H., përfaqësuar me anë të mbrojtëses së tij Klodiana Sanxhaku, paraqet kërkesën për shuarjen e masës së sigurimit “Arrest në burg” dhe lirimin e menjëhershëm parashikuar nga neni 261 e vijues i K.Pr.Penale, pasi rezultoi se është arrestuar në flagrancë në datën 16.06.2022 dhe me vendimin me nr. 385 datë 08.02.2023 është dënuar përfundimisht me 1 (një) vit burgim.

Në nenin 261 të K.Pr.Penale, konkretisht në pikën c) parashikohet se ... *“Masat e sigurimit shuhen kur kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se sa masa e dënimit të caktuar....”*. Në interpretim të dispozitës së mësipërme, nëse kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur nga i pandehuri është më e madhe se dënimi i vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, atëherë masa e sigurimit personal “Arrest në burg” e vendosur ndaj të pandehurit nuk mund të vazhdojë të ekzekutohet.

Duke ju kthyer rastit, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin me nr. 395 datë 08.02.2023, i pandehuri është dënuar, në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, përfundimisht me 1 (një) vit burgim për kryerjen e veprës penale të “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Pr. Penale. Sipas këtij vendimi, vuajtja e dënimit fillon nga data 16.06.2022, kur i pandehuri është arrestuar. Gjatë gjykimit i pandehuri është gjykuar me masën e sigurimit “Arrest në burg” nga data 16.06.2022 e deri më sot. Bazuar në nenin 7 të Ligjit nr.7942 datë 31.05.1995 “Për hyrjen në fuqi të Kodit penal”, një ditë paraburgim e vuajtur nga i pandehuri nën masën “arrest në burg”, është e barabartë me një ditë e gjysëm burgim. Në këto kushte, rezultoi se i pandehuri e ka vuajtur të plotë dënimit me dt.16.02.2023, pasi kohëzgjatja e paraburgimit, që është duke vuajtur, është më e madhe se dënimi i caktuar nga gjykata.

Në këto kushte, në datën 16.02.2023, Gjykata ka qënë e detyruar nga ligji, të vendosë shuarjen e masës së sigurimit dhe lirimin e menjëhershëm të këtij të pandehuri.

**GJYKATA E TIRANES**